



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Procesverbal

Konsultim publik :

Data : 18/08/2025 **Ora :** 10 :00

Vendi: Fshati Cërravë

Numri i pjesëmarrësve : Gjithësej 28 persona të pranishëm

Titulli i Projekt-aktet që konsultohen :

**PËR MIRATIMIN E LISTËS TË SIPËRFAQES SË TOKËS PREJ 35,5200 HA,
E NDODHUR NË NJËSINË ADMINISTRATIVE ÇËRRAVË QË MUND TË
JEPEN ME QIRA.**

**PER MIRATIMIN NË PARIM TË DHËNIES ME QIRA, NË FAVOR TE
INDIVIDEVE KËRKUES PËR NDERTIM FOTOVOLTAIKE (STACIONET,
BAZAMENTET DHE OBJEKTET PËRKATËSE ETJ.), TË PASURISË ME
SIPËRFAQE TOTALE 303259 M2 (Treqind e tremije e dyqind e pesedhjetë e
nentemije) M2.**

Pjesëmarrës :

Ahmed Guxholli	(Këshilltar)
Odhise Mihallari	(Këshilltar)
Vjollca Pllaha	(Këshilltare)
Nexhmi Torra	(Specialist I Bashkisë)
Jona Bojko	(Sekretare e Këshillit)

Olger Ibi (Administrator I njësisë Cërravë) bëri një prezantim të shkurtër në lidhje me :

-Projekt-aktin e propozuar dhe realcionin shoqërues.

- Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik.
- Shtroi pyetjet konkrete që ka për pjesëmarrësit.
- Jep informacion për adresat ku mund të dërgohen rekomandimet dhe afatin përkatës.
- Tregoi kalendarin e konsultimi publik dhe sqaroi procedurën si do të trajtohen rekomandimet.

Jona Bojko (Sekretare e Këshillit): Në mbledhjen e muajit Korrik të Këshillit Bashkiak u përcollën dokumentat e dy projekt-vendimeve .

PËR MIRATIMIN E LISTËS TË SIPËRFAQES SË TOKËS PREJ 35,5200 HA, E NDODHUR NË NJËSINË ADMINISTRATIVE ÇËRRAVË QË MUND TË JEPEN ME QIRA.

PER MIRATIMIN NË PARIM TË DHËNIES ME QIRA, NË FAVOR TE INDIVIDEVE KËRKUES PËR NDERTIM FOTOVOLTAIKE (STACIONET, BAZAMENTET DHE OBJEKTET PËRKATËSE ETJ.), TË PASURISË ME SIPËRFAQE TOTALE 303259 M2 (Treqind e tremije e dyqind e pesedhjetë e nentemije) M2.

Këshilli vendosi që këto projekt-vendime të kalojnë në konsultim publik dhe ne kemi ardh sot për të dëgjuar mendimin tuaj në lidhje me dhënien me qera të këtyre sipërfaqeve për ndërtim fotovoltaike. **N. Torra:** Mbas verifikimeve që kemi bërë në drejtorinë e Ashk dhe duke u nisur nga kërkesat që kani bërë subjekte të ndryshme për zhvillime të reja që kanë marrë kryesisht në shfrytëzimin e energjisë së gjelbër, kemi një kërkesë për zhvillimin e kësaj zonës. Ne i kemi ndarë në dy kategori. Një pjesë janë toka pyjore dhe pjesa tjetër që është krah perballë. Parimisht dhe teknikisht në momentin kur te bëhet kontrata do vecohen dhe hapësirat të cilat kanë pronar. Procedurat do jenë të hapura dhe secili që ka interes mund të aplikojë.

Rafet Kapo: Ne duam ti marrim si fshat. E marim me qera dhe paguajme qeranë dhe taksat që duhet

Genci Beshello: Ne jemi interesuar para disa vitesh për ti marrë me qera dhe nuk na janë aprovuar. Vendoseni veten tuaj në vendin tonë. Ne këto toka kemi për përdorim, nqs na i marrim dhe këto skemi vcfarë të bëjmë. Përcillen mendimin tonë. Gjithashtu para disa kohësh kur kemi bërë takim na është premtuar që do na jepet mbështetje për kullotata dhe spo shohim asgjë.

Anis Dervishi; Ne me kullotat ushqejmë familjet tona. Kullotat jsnë e ardhura e vetme që kanë shumë familje. Ne nuk po kërkojmë asgjë vetëm të na lini këto tokat që kemi në mënyrë që të vazhdojmë të mbajmë familjen.

N.Torra: Kullotat do jenë gjithsesi.

G. Beshello; Ne nuk bijem dakort sepse janë tokat që ne duam të kullosim bagëtitë.

Lulëzim Kapa; Në një takim na kanë thënë që kullotata nuk do të zihen. Ne jemi dakort që këto toka t mbajë Bashkia dhe ne ti marrim me qera për të kullotur bagëtitë. Ne jemi të gjithë të gatshëm të paguajmë taksa.

Andrea Beshello: Nqs ne na sigurojnë që do punësohet një pjesë e mirë e banorëve të fshatit atëherë n bijem dakort.

Lulëzim Kapa: Gjithashtu kemi një shqetësim tek rezervuari i Grabovicës, banorët nuk janë dakort të mbahet peshk sepse i pengon për të ujitur.

Genci Beshello: Perfundimi është që ne nuk jemi dakort që keto toka të jepen me qera , nqs duhet i marrim vete jemi të gatshëm.

Sekretare e Këshillit

Jona BOJKO



Nuk jemi do. port te gjitha

..... / /

Deafet Kapa ~~AD~~
Selmend Bebelli ~~AD~~

Zamin Kapa ~~AD~~
Ljuro Kapa ~~AD~~
Altin Kapa ~~AD~~

Rivijon Kapa ~~AD~~
Gozmor Bebelli ~~AD~~
Genci Bebelli ~~AD~~

Anitau Bebelli ~~AD~~
Envis Kapa ~~AD~~
Envis Dervishi ~~AD~~

Lorim Kapa ~~AD~~
- edio Harro ~~AD~~
Indrea Bebelli ~~AD~~

Ardit Kapa ~~AD~~
FREDI KAPA ~~AD~~
ANKHI KAPA ~~AD~~

Moile Kapa ~~AD~~
PERPARIM Kapa ~~AD~~
- ndri Kapa ~~AD~~

ALTIN Bebelli ~~AD~~